



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT  
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga 1355  
Komisioneri shtetëror i Zgjedhjeve dhe mban nga dërguesi nr. \_\_\_ prot  
datë 28/05/2024 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (tënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 1975  
31/05/2024 datë

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosinë:


Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më

31/05/2024

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 28.5.2024

Nr. 1388 Prot.

**Lënda:** Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Dibër

Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

**Partisë Republikane Shqiptare**

Rr. "Abdi Toptani", Ish Hotel Drini, Kati III, Tiranë

**Zj. Nertila Dik Kaza**  
Shumbat, Dibër

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të dates 24.05.2024, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Republikane Shqiptare" zj. Nertila Dik Kaza.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 51, datë 24.5.2024.


Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Sekretar i Përgjithshëm**

(Në mungesë dhe me urdhër)

**Majlinda ÇELMETA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.5.2024

Nr: 51

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË REPUBLIKANE  
SHQIPTARE", ZJ. NERTILA DIK KAZA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 845 prot., datë 01.03.2024, këshilli i bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Shukri Idriz Shehu, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Republikane Shqiptare.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Republikane Shqiptare, për këshillin e bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, zj. Nertila Dik Kaza.

Me shkresën nr. 1098, prot., datë 23.04.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, zj. Nertila Dik Kaza, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të

Data: 24.5.2024 Nr: 51  
Ora: 12:00



Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Republikane Shqiptare", zj. Nertila Dik Kaza.

dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Republikane Shqiptare, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DI-PR-18341\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Nertila Dik Kaza, rezulton se në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga "SPATA" në "KAZA".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 1175 prot., datë 02.05.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1171 prot., datë 02.05.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Nertila Dik Kaza

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 5198/1 prot., datë 16.05.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Nertila Dik Kaza, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 7410/1 prot., datë 14.05.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Nertila Dik Kaza, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Nertila Dik Kaza, në këshillin e bashkisë Dibër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 24.5.2024 Nr: 51  
Ora: 12:00



Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Republikane Shqiptare", zj. Nertila Dik Kaza.

**VENDOS:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Republikane Shqiptare", zj. Nertila Dik Kaza.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

